

REFIMI

Ati Shpirtëror e shpie atë, që desherón te refehet, përpara Kores se Zotit tone Jesú Krisht, edhe thote:

Shenjt Perëndí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (3 here).

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përhere dhe në jetet e jéteve. Amín.

Triní e tëreshenjte, meshirona; o Zot, hiresoji mekatat tona; o Kryezót, fal-i paudhesite tona; o i Shenjte, veshtroji, dhe sheroji semundjet tona për emrin tent. Meshiró, o Zot (3 here).

Ati ynë, që je në qell, u-shenjterofte emri yt; arthte Mbretëria jote; u-befte dëshira jote si në qell edhe mi dhé; buken tone të perdíçime épnaje

neve sot; edhe fálnaji fajet, sikunder edhe né ua falim fajtóreve tanc; edhe mos na shtjer ne ngasje, po shpetona nga i ligu.

Se jotja eshte Mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

Meshiró, o Zot (12 *here*). Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín. Ejani ti fálemi dhe ti pergjúnjemi Krishtit, Perendisë dhe Mbretit tone (3 *here*).

PSALMI 51.

Meshiromë, o Perendí meshireplót, edhe me shumicen e meshírave te tua shúaji paudhesít' e mia. Laj-më fare prej paudhesise sime, dhe qerome prej mekatit tim. Se un' i njoh paudhesít' e mia, dhe mekatin tim e kam perpara syve kurdoherë. Kunder teje vetem fejeva, dhe perpara teje e bera te keqen, qe te dalesh i drejte ne fjalet e tua, dhe te jesh i kthjellët ne gjyqet e tu. Se ja tek u-zura ne paudhesí, dhe ne mekata me lindi nena ime. Se ja tek deshe te verteten ne zemer, dhe mendjes sime do ti tregósh urtesí. Sperkat-më me hysóp, dhe do te qerohem, laj-më, dhe do te behem mé i bardhe se debora. Bej-më te degjónj gezím e ngazellím, qe te me gezohen eshtrat e thýera. Ktheje faqen nga mekatat e mia, dhe shúaji gjithë paudhesít' e mia. Kthjelloma zemren, o Perendí, dhe perscritma frymen e drejte. Mos me hith tej prej faqes sate, dhe mos ma merr frymen

tende te shenjtc. Epma prapë gezimin e shpetimit tent, edhe forcome me fryme zoterishte. Do tu mesónj fajtóreve udhet e tua, dhe te pabeset do te kthehen me ty. Shpetome prej gjakrash, o Perendí, Perendia i shpetimit tim, gjuha ime do ta lavderonje me gezím drejtesine tende. O Zot, çelmi buzët, edhe goja ime do ta leçite lavdine tende. Se te dáshkeshe therore, do te kisha prurë, po hollokostet nuke te pelqejne. Therore e Perendisë eshte frym' e thyer; zemren e thyer dhe te perunjur nuke do ta hedhesh tej, o Perendí. Bej-i mire Sionës pas pelqimit tent; edhe ndertoji muret e Jerusalemit. Ahere do te pelqësh therore drejtesie, dhurata dhe hollokoste. Ahere do te bien dema mi Alltarin tent, edhe meshiromë, o Perendí.

Me paqe le ti lútemi Zotit.

Per ndjesen e mekátave te sherbetorit te Perendisë (*aksh*), dhe qe ti falen te gjitha fajet e dáshura dhe te padáshura, le ti lútemi Zotit.

Qe te shpetojme prej çdo hidherimi, merie, reziku dhe nevoje, le ti lútemi Zotit.

Perkrahna, shpetona, meshirona dhe rúajna, o Perendí, me hirin tent.

Tereshenjten, te pacinúaren, te permibekúaren, te lavderúaren, Kryezonjen tone, Hyjlíndesen dhe gjithënjé Virgjereshen Marí dyke kujtuar me gjithë Shenjtoret, veten tone dhe njerjatrín dhe tere jeten tone Krishtit Perendí le tja pranojme.

Se ty të ka hie çdo lavdí, nder e adhurím, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

Pastáj Prifti thote keté Urate:

O Perendí, o Shpetimtari yne, qe nuke desherón vdekjen e mekatáreve, po kthimin dhe shpetimin e tyre, prit-i sherbetoret e tu, qe pendohen per fajet, qe kane bere, se ti ke thenc qe do ti falesh mekatat gjer me shtatedhjetë here shtate; dhe ti ke thenc: "Sa të lithni mi dhé, do të jenc të lídhura në qell; dhe sa të zgjithni mi dhé, do të jenc të zgjídura në qell." Se ti je i vétemi i pamekatme, dhe ty të dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe në jetet e jéteve. Amín.

Pastáj Prifti e pyét te pendúarin:

Bir, á besón në mesimet, qe na jep Kisha e shenjte e Pergjitheshme dhe Apostollore?

I penduari thote Simbolin e Beses:

Besónj me një Perendí, Atin e terefueqishim, krijetarin e qellit e të dheut e të gjithë të dúkurave dhe të padúkurave. Dhe me një Zot Jesú Krisht, të vétemin Bir të Perendise, qe lindi prej Atit perpara gjithë jéteve. Drite prej Drite, Perendí të vertete prej Perendie të vertete, qe lindi, dhe nuk u-be, të bashkeqenshim me Atin, me anen e të cilit u-benc të gjitha. Qe per né njërczit edhe per shpetimin tone zbriti prej qellit, edhe u-misherua prej Shpirtit Shenjt edhe Virgjreshes Marí, dhe u-be njerí. Qe u-kryqesua per né me

kohen e Pontit Pilát, edhe vojti, dhe u-varró. Dhe u-ngjall me të trefen dite pas Shkrónjave. Dhe u-ngjiti në qell, dhe ndenji me të djathten e Atit, edhe do të vinje prapë me lavdí të gjykonje të gjallet e të vdëkurit, edhe Mbreteri' e tij do mos ketë mbarím. Dhe me Shpirtin Shenjt, Zotin e jetebéresin, qe dergohet prej Atit, qe adhurohet, e lavderohet me Atin e me Birin, qe foli me anen e Proféteve. Me një Kishe të Shenjte, të Pergjitheshme dhe Apostollore. Refénj një Pagezím per ndjesen e mekatave. Pres ngjalljen e të vdëkurve dhe jeten e botës qe vjen. Amín.

Pastáj Prifti i thote te pendúarit:

Bir, mos kij turp, po mi refé të gjitha mekatat e tua; se nuke mi thua mua, po Perendise, perpara të cilit qendron.

Passi e pyét per të gjitha mekatat, e keshillón te mos i persedyte, pastáj i thote te pendúarit:

Bjer me gjunje.

I penduari bie me gjunje, Prifti i ve doren mi koke, dhe thote keté Urate:

Le ti lútemi Zotit.

O Zot, o Perendí hirplót, meshireplót e zemer-gjere, kij meshire per sherbetoret e tu, dhe ndjeji; fal-i mekatat, paudhesite, fajet e dáshura dhe të padáshura, me dije a padije, me fjale a me punc, qe kane bere si njerës, qe rojne në keté bote; paj-toji, dhe bashkoji me Kishen tende të shenjte me anen e Zotit tone Jesú Krisht, me të cilin je i be-

kuar, bashkë me Shpirtin e tërështenjtë dhe të mirë dhe jetëberës, tanë e përherë dhe në jetët e jetëve. Amin.

Pastáj Pifti këndón Uraten e Ndjeses:

Le të lútemi Zotit.

Zoti ynë Jesú Krisht, më hirin dhe njeridashjen e tij, jua ndjefte të gjitha mëkatat túaja. Dhe unë, Pifti i pavyer, më fuqinë, që më ka dhënë aý, ju ndjenj, edhe ju çlirónj prej gjithë mëkátave túaja, më emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt. Amin.

Pastáj Pifti ben shenjen e Kryqit mi koken e të pendúarit, i cili i puth doren.